

# AKT - THEMELIMI

"Berati Tours Albania" SHPK (BTA)

Njësia Bashkiake nr.7, Rruga Ndre Mjeda, Kompleksi Magnet, Objekti DORADO, Kati 1, A1- 1023, Tiranë

## AKT THEMELIMI

PËR

SHOQËRINË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Berati Tours Albania" SHPK

KREU I

EMËRTIMI, FORMA JURIDIKE, SELIA, KOHËZGJATIA, OBJEKTI, VULA

### NENI 1 – EMËRTIMI

Emërtimi i shoqërisë është "Berati Tours Albania" SHPK dhe shkurtimisht do të identifikohet me akronimin "BTA".

### NENI 2 - FORMA JURIDIKE

Shoqëria "Berati Tours Albania" SHPK, është person juridik, shoqëri tregtare me aktivitet të përqendruar kryesisht në sektorin e turizmit , (më poshtë e quajtur Shoqëria).

Shoqëria fiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria, në përputhje me kushtet dhe personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj .

1. Kapitali i Shoqërisë përbëhet prej dy kuotash dhe krijohet nga kontributi i ortakëve:
  - **Z. Martin Klaus HEUSINGER**, atësia Klaus, amësia Hildegard, lindur në Gjermani, me dtl. 27.09.1968, me adresë: Rr. "Kostandin Leka", Nd. 13, H. 1, Berat; shtetas gjerman, me Lejeqëndrim ID nr. 839162846-G83927004H, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
  - **Z. Edmond ÇOBO**, atësia Nuri, amësia Hajri, lindur në Ura Vajgurore, Shqipëri me dtl. 07.03.1975, me adresë: Nj. Bashkiake Nr. 9, Rr. "Petrela", Nd. 7, H. 2, Ap. 1, Tiranë; shtetësi shqiptare, me Letërnjoftim ID nr. 036567331-H50307004, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulojnë personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

### NENI 3 - SELIA

Shoqëria do të ketë selinë ligjore në adresën: "Tiranë Njësia Bashkiake nr.7, Rruga Ndre Mjeda, Kompleksi Magnet, Objekti DORADO, Kati 1, A1-1023".

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësie, degë, të krijojë filial, si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të ortakëve të shoqërisë.

# AKT - THEMELIMI

"Berati Tours Albania" SHPK (d.d.a)

Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Ndre Mjeda, Kompleksi Magnet, Objekti DORADO, Kati 1, AI- 1023, Tirane

## NENI 4 - KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar, mbi 5 (pesë) vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## NENI 5 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në RSH, për shoqëritë që ushtrojnë aktivitet ekonomik, objekti veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Ofrimi i shërbimeve në sektorin e turizmit;
- Menaxhim projektsh në fushën e marketingut, e destinacionit dhe zhvillimin e komuniteteve vendore.

## NENI 6 - VULA

Shoqëria ka vulën e saj, në brendësi të së cilës shkruhet emërtimi i shoqërisë "BERATI TOURS" shpk, ndërsa akronimi i saj është **BTA**.

Të gjitha aktet që dalin nga Shoqëria, pasi nënshkruhen sipas ligjit, vulozen me vulën e shoqërisë.

## KREU II

### NENI 7 – KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100.000 (NJËQIND MIJË) Lekë. Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët themelues të shoqërisë **Z. Martin Klaus HEUSINGER** dhe **Z. Edmond ÇOBO**, secili pronar i një kuote me vlerë 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, që së bashku përbëjnë 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

### NENI 8 - MËNYRA E FITIMIT DHE KALIMI I KUOTAVE

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) Kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
  - b) Shitblerjes;
  - c) Trashëgimisë;
  - d) Dhurimit;
  - e) Çdo mënyre tjetër të parashikuara në ligj
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
3. Çdo transferim i kuotave tek të tretët bëhet me vendim të ortakëve, nëpërmjet një akti noterial të posaçëm për transferimin e kuotave.

### NENI 9 - ORGANI VENDIMARRËS

Ortakët janë organi i vetëm vendimarrës i kësaj shoqërie.

1. Ortakët janë përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) Ndryshimin e statutit;
  - c) Emërimin e administratorëve;
  - d) Emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve;

*[Signature]*

*[Signature]*  
2 | Page



# AKT - THEMELIMI

"Herold Tours Albania" s.p.a. p.a.

Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Ndre Mjeda, Kompleksi Magnet, Objekti DORADO, Kati 1, AI- 1023, Tirane

- e) Miratimin e politikave tregtare të ndjekura nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - g) Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratës;
  - h) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - i) Çështje të tjera të parashikuara në ligj;
2. Ortakët marrin vendime për çështjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatëse.
- Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Në këtë regjistër duhet të regjistrohen :
- a) Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) Shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
  - c) Investimet;
  - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

## NENI 10 - ADMINISTRIMI

1. Në pozicionin e Administratorit të Shoqërisë, emërohet për një afat 5 – vjeçar me të drejtë ripërsëritje, **Z.Edmond Çobo**.
2. Ortakët mund të emërojnë një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë pa qenë ortakë të Shoqërisë. Afati i emërimit të tyre nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërsëritje.
3. Nëse ortakët emërojnë më shumë se një administrator, ata administrojnë bashkërisht shoqërinë.
4. Ortakët mund të shkarkojnë administratorin me vendim të posaçëm .

## NENI 11 - TË DREJTAT DHE DEYRIMET E ADMINISTRATORIT

Administratori i Shoqërisë ka këto të drejta dhe detyrime:

- a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Ortakët;
- b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Ortakëve për miratim;
- e) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raporton përpara ortakëve, në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme, me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) njofton ortakët për të marrë vendimet përkatëse në rastet kur nga bilanci vjetor apo raportet e ndërmjetme financiare, rezulton që aktivet e shoqërisë nuk mund të mbulojnë detyrimet e kërkueshme;
- i) gjatë kryerjes së detyrës së tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të

# AKT - THEMELIMI

"Borax Tona Albania" NIKETI (SHK)

Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Ndre Mjeda, Kompleksi Magnet, Objekti DORADO, Kati 1, AF- 1023, Tirane

hetimit dhe vlerësimit të informacionit përkatës, rezulton se veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim;

- j) nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe ligjin, është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëme që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe të kalojë çdo fitim personal që ai apo person tjetër i lidhur me të kanë përfituar nga këto veprime të parregullta;
- k) në interesin e mirë të Shoqërisë në tërësi, administron çështjet për të cilat merret vendimi;
- l) parandalon dhe mënjanon rastet e konfliktit, prezente ose të mundshme të interesave personale me ato të Shoqërisë;
- m) ushtron detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm;
- n) kryen detyra të tjera të percaktuara me ligj dhe në statut.

## NENI 12 - VITI FINANCIAR

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe do të mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Përjashtim bën viti i parë financiar i Shoqërisë që fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mbyllet me 31 dhjetor të po atij viti .

## NENI 13 - PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Shpërndarja ose prishja e Shoqërisë mund të behet në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar, siç mund të jenë:

- a) humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj;
- b) në një nga mënyrat e parashikuara në dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë procedurat e falimentimit të shoqërive tregtare;
- c) kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare;

Në këto raste ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëria në likuidim e sipër".

## NENI 14 - MOSMARRËVESHJET

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij akti themelimi, si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente gjykata shqiptare.

Tiranë më 01.03.2024

## ORTAKËT THEMELUES

Martin Klaus HEUSINGER

MARTIN HEUSINGER  
(emër, mbiemër/ firmë)



Edmond ÇOBO

EDMOND ÇOBO  
(emër, mbiemër/ firmë).

